

# Sintaksa e urdherit per zgjedhje te dy mundesive


Lenda: Gjuhët programore

# Kushtet - Degezimi

- Gjatë shkruarjes së programeve për raste të ndryshme, paraqitet nevoja e kushtëzimit të ekzekutimit të urdhërave në bazë të ndonjë kushti të caktuar. Në C++ kemi disa forma të paraqitjes së kushteve: Rasti më i thjeshtë është kur për ndonjë kusht të caktuar ekzekutohet urdhëri (ose urdhërat), kurse nëse nuk plotësohet kushti, nuk ndodhë asgjë por programi vazhdon me urdhërin e ardhëshëm (vijues), si në vazhdim:
- **if (kushti) urdhëri ;**
- **ku:**
- **kushti - kushti për degëzim**
- **urdhëri – urdhëri që ekzekutohet nëse plotësohet kushti k**
- Zakonisht, në program kushti shkruhet në rresht të veçantë:
- **if (kushti)**
- **urdhëri;**

# //Programi if1a

- `// Programi if1a`
- `#include <iostream>`
- `using namespace std;`
- `int main()`
- `{`
- `int x;`
- `cout << "Vlera x=";`
- `cin >> x;`
- `if (x > 0)`
- `cout << "\nx eshte pozitiv \n";`
- `return 0;`
- `}`



Gjatë shkruarjes së programeve, përdoren operatorët aritmetik dhe operatorët relacional:


Operatori në C++	Operacioni	Shembull	Rezultati
+	Mbledhja	3+2	5
-	Zbritja	3-2	1
*	Shumëzimi	3*2	6
/	Pjestimi	3/2	1.5
%	Moduli	3%2	1

\*Moduli, është mbetja nga pjesëtimi i plotë (5%2=1; 8%3=2).

Operatori në C++	Domethënia	Shembull	Rezultati
<	Më i vogël se	2 < 3	true
<=	Më i vogël se, ose barazi me	3 <= 2	false
==	Barazi me	3 == 3	true
>	Më i madhë se	3 > 2	true
>=	Më i madhë se, ose barazi me	2 >= 3	false
!=	Jobarazi me	2 != 3	true

# //Programi if1b

- `// Programi if1b`
- `#include <iostream>`
- `using namespace std;`
- `int main()`
- `{`
- `int x;`
- `cout << "Vlera x=";`
- `cin >> x;`
- `if (x > 0)`
- `cout << "\n x eshte pozitiv \n";`
- `if (x < 0)`
- `cout << "\n x eshte negativ \n";`
- `return 0;`
- `}`



# //Programi if2


- // Programi if2
- #include <iostream>
- using namespace std;
- int main()
- {
- int x;
- cout << "Vlera x=";
- cin >> x;
- if ((x%2) == 0)
- cout << "\n x eshte cift\n";
- if ((x%2) == 1)
- cout << "\n x eshte tek\n";
- return 0;
- }

# Sqarim...

- Kemi edhe rastin kur për ndonjë kusht të caktuar ekzekutohet urdhëri (ose urdhërat), kurse nëse nuk plotësohet kushti duhet të ekzekutohet ndonjë urdhër tjetër, si në vazhdim:
- **If (kushti)**
- **urdhëri1;**
- **else**
- **urdhëri2;**
- **kushti** - kushti për degëzim.
- **urdhëri1** - urdhëri që ekzekutohet nëse plotësohet kushti k.
- **urdhëri2** – urdhëri që ekzekutohet nëse nuk plotësohet kushti k.

# //Programi if2a

- // Programi if2a
- #include <iostream>
- using namespace std;
- int main()
- {
- int x;
- cout << "Vlera x=";
- cin >> x;
- if (x > 0)
- cout << "\nx eshte pozitiv \n";
- else
- cout << "\nx eshte negativ\n";
- return 0;
- }





# Blloqet e urdherave ne dege

- Nësë për një kusht duhet të ekzekutohen disa urdhëra (më shumë se një urdhër), atëherë urdhërat e tillë duhet të futen brenda kllapave të mëdha, duke krijuar një bllok të urdhërave.
- **if (kushti)**
- {
- **urdhërat<sub>1</sub>;**
- }
- **else**
- {
- **urdhërat<sub>2</sub>;**
- }

# //Programi if3

- // Programi if3
- #include <iostream>
- using namespace std;
- int main()
- {
- int x,y,z;
- cout << "Vlera x=";
- cin >> x;
- if (x > 0)

```
{  
y=2*x;  
z=x*x;  
cout << "\ny=2*x="<<y;  
cout << "\nz=x*x="<<z;  
}  
else  
cout << "\nx eshte negativ\n";  
cout<<endl;  
return 0;  
}
```

Algoritmi i kodit programot te mesiperme if3

